



Nr. 764 prot.

Tiranë, 12/05/2025

Nr. 964 prot.

Tiranë, 12/05/2025

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet


**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**


**DHE**

**FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT**

**PËR**

**KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI**

**ROBERT GAJDA**  
  
\_\_\_\_\_  
**KOMISIONER**



**PËR**

**FEDERATËN SHQIPTARE TË  
FUTBOLLIT**

**ILIR SHULKU**  
  
\_\_\_\_\_  
**SEKRETAR I PERGJITHSHEM**



1



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*Ndërmjet*

**Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

*Dhe*

**Federatës Shqiptare të Futbollit**

*Lidhur sot më \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_, në Tiranë ndërmjet:*

**Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, përfaqësuar nga Komisioneri Z. Robert Gajda, me adresë: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, në vijim cilësuar si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

dhe

**Federatës Shqiptare të Futbollit**, përfaqësuar nga Sekretar i Përgjithshëm z. Ilir Shulku, me adresë:


Rruga "Liman Kaba", Ndërtesa Nr. 5, Hyrja 1, Njësia Administrative 5, Kodi Postar 1019, Tiranë.

Institucioni i **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, si person juridik publik, i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, dhe **Federata Shqiptare e Futbollit**, si person juridik, e organizuar si shoqatë, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave dhe klubeve sportive të futbollit në Republikën e Shqipërisë, kanë një eksperiencë dhe përvojë të gjatë në garantimin e zbatimit dhe realizimit të misioneve të përbashkëta në mbrojtjen e të drejtave me në fokus antidiskriminimin dhe luftën kundër gjuhës së urrejtjes, dhe dëshirojnë që të çojnë përpara bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet tyre në këtë fushë, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, për sa më poshtë:

### **Neni 1**

#### **OBJEKTI**

Kjo marrëveshje ka për objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Federata Shqiptare e Futbollit do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të bashkëpunimit të ndërsjelltë, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm.





## **Neni 2 QËLLIMI**

Kjo marrëveshje ka për qëllim, realizimin e veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut në lidhje me çështje sportive dhe jo vetëm; rritjen e bashkëpunimeve për iniciativa të përbashkëta; rritjen e bashkëpunimit në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, të transparencës dhe të llogaridhënies; ndërhyrjen pozitive të institucioneve shtetërore sa herë që është e nevojshme; si dhe synon të krijojë një qasje të koordinuar, të bazuar në edukim, masa ligjore, përfshirje komunitare dhe partneritete ndërkombëtare, për të garantuar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë pjesëmarrësit në fushën e sportit.

## **Neni 3 FUSHA E ZBATIMIT**

Marrëveshja do të zbatohet midis Palëve të lartëpërmendura në fushën që përmban kjo Marrëveshje për të përmbushur qëllimin e saj.

Nëpërmjet kësaj Marrëveshje, Palët angazhohen të:

- 3.1 Të krijojnë një mjedis sportiv pa diskriminim dhe gjuhë urrejtjeje në futbollin shqiptar, duke ndërgjegjësuar, edukuar dhe ndëshkuar çdo formë sjelljeje që bie ndesh me vlerat e barazisë, respektit dhe të drejtave të njeriut.
- 3.2 Të përfshihen nëpërmjet angazhimit institucional të përbashkët për ndryshime ligjore që lidhen me fushat me interes të përbashkët;
- 3.3 Të njoftojnë njeri-tjetrin mbi raste konkrete që kërkojnë trajtim institucional;
- 3.4 Të organizojnë aktivitete, evente, trajnime, si dhe e projekte të përbashkëta, apo të ftojnë Palën tjetër për pjesëmarrje në aktivitete të tilla me interes të përbashkët;
- 3.5 Të përfshihen në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e edukimit, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit për luftën kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes;
- 3.6 Të bashkëpunojnë dhe marrin pjesë në hartimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme për fushat me interes të përbashkët.
- 3.7 Të bashkëpunojnë për hartimin e Plan Veprimeve, për luftën kundër diskriminimit dhe parandalimin e incidenteve të përsëritura.
- 3.8 Të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen, ndaj lista e mësipërme nuk është e natyrës shteruese.

## **Neni 4 MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI**

Palët marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave apo informacioneve me të cilat janë vënë në dijeni gjatë bashkëpunimit të tyre. Ruajtja dhe përpunimi i informacionit të





shkëmbyer do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Neni 5

### KOMUNIKIMI NDËRMJET PALËVE

- 5.1. Palët angazhohen të mbliidhen në mënyrë periodike, sa herë të gjykohet e nevojshme, por jo më rrallë se një herë në 6 muaj.
- 5.2. Palët caktojnë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret edhe në rugë operationale të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, si dhe për shkëmbimin e informacionit lidhur me të, si vijon:
  - a. Për KMD-në: znj. Brunilda Menalla  
kontakt: [Brnilda.Menalla@kmd.al](mailto:Brnilda.Menalla@kmd.al) / [REDACTED]
  - b. Për FSHF-në: z. Tedi Agalliu  
kontakt: [tagalliu@fshf.al](mailto:tagalliu@fshf.al) / [REDACTED]
- 5.3 Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë një informacion të rëndësishëm dhe urgjent për t'u përcjellë, komunikimi mund të bëhet dhe në mënyrë elektronike dhe verbale, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

#### NENI 6

### KOHËZGJATJA

- 6.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore pa afat të përcaktuar, për aq kohë sa do të gjykohet si i nevojshëm dhe i domosdoshëm bashkëpunimi midis palëve.
- 6.2 Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim palën tjetër.

#### Neni 7

### AMENDIME TË MARRËVESHJES

Marrëveshja mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjelltë të Palëve, në mënyrë shkresore, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

#### Neni 8

### DISPOZITA TË FUNDIT

- 8.1 Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis Palëve, duke bërë përpjekje konkrete për zgjidhjen e situatës.
- 8.2 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, nënshkruhet dhe protokollohet nga çdo palë dhe secila palë mban një kopje origjinale.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



8.3 Kjo Marrëveshje është e hapur dhe mund t'i bashkohet çdo organizatë jofitimprurëse, objekti i veprimtarisë të së cilës përputhet me këtë Marrëveshje dhe bie dakord me këto parime.

**PËR**

**KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI**

**ROBERT GAJDA**

**KOMISIONERI**



**PËR**

**FEDERATËN SHQIPTARE TË  
FUTBOLLIT**

**ILIR SHULKU**

**SEKRETAR I PËRGJITHSHEM**



